



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 934 , datë 12. 08.2009

Për

miratim të Autorizimit Individual të sipërmarrësit “Eden” sh.p.k për caktim dhe përdorim të serive numerike për bashkinë Fier

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 12.08.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, date 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, date 02.05.2008, e amenduar me VKD Nr. 746 dt. 17.07.09, bazuar në ligjin Nr. 9918 date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

1. Propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Eden” shpk për caktim numeracioni për përdorim në bashkinë Fier.

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – germa j) dhe nenet 80 deri 90;
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 date 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Eden” shpk për caktim numeracioni për përdorim në bashkinë Fier, deri në miratimin e rregullores për numeracionin, si më poshtë:

Nr	Bashkia	NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
			Fillimi	Mbarimi		
1.	FIER	34	510.000	510.999	1.000	XX YYYYYY

- a) Formati i Numrit Sinjifikativ Kombëtar (NSN) është me 8-shifra, dhe ka konfigurimin e treguar në kolonë, ku shenjat X tregojnë sasinë e shifrave që formojnë NDC (Kodin e Destinimit Kombëtar - *National Destination Code*) dhe shenjat Y tregojnë sasinë e shifrave që formojnë SN (Numrin e Pajtimtarit - *Subscriber Number*).

b) Formati i numrit për të realizuar thirrje :

- Kombëtare brenda Zonës së Numeracionit - vetëm SN
 - Kombëtare jashtë Zonës së Numeracionit - **0** + NDC + SN [0 + NSN]
 - Ndërkombëtare: - **00** + CC + NSN
- [ku : CC-Kodi (Prefiksi) i Vendit]

c) **NUMERACIONI I SHKURTUAR**

- 0** - Prefiksi për thirrjet kombetare (brenda vendit por jashtë zones perkatese te numeracionit)
- 00** - Prefiksi për thirrjet nderkombetare.
- 112** - Numri i urgjences ¹.
- 118** - Rubrika e sherbimeve te Informacionit ².
- 120** - Prenotim i komunikimeve kombetare
- 1211** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet kombetare.
- 1212** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet nderkombetare
- 122** - Prenotim i komunikimeve nderkombetare.
- 123** - Njoftim per prishje linje, telefoni.
- 124** - Informacion per numeratorin.
- 126** - Policia Rrugore (*Sherbim Urgjence*) ³
- 127** - Urgjenca mjekesore (*Sherbim urgjence*) ⁴.
- 128** - Zjarrefiksati (*Sherbim urgjence*) ⁵.
- 129** - Policia e rendit (*Sherbim urgjence*) ⁶.
- 1891** - Hapja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.
- 1892** - Mbyllja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.

2. Ngarkohen Drejtoria e Licensimit për njoftimin e sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera të AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

- 1. Afrim TONUZI**
- 2. Edlira KASAJ**
- 3. Ilir ZELA**
- 4. Jetmir KARINI**

¹. Thirrjet ne kete numer duhet te rrugesohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipermarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

². Ne vartesi te sasise se sherbimeve te vecanta qe sipermarresi kerkon te identifikojë brenda kesaj rubrike, kodi i shkurter "118" mund te konfigurohet edhe ne formen "118 X..". Ne kete rast nuk merret miratim ne AKEP, por vetem njoftohet.

³. Thirrjet ne kete numer duhet te rrugesohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipermarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

⁴. I njejte me shenimin nr.3.

⁵. I njejte me shenimin nr.3.

⁶. I njejte me shenimin nr.3.